



Prishtinë / Priština
Nr./Br. 2494-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 si dhe nenin 3.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.12.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ.DRITA BUZA ZHAVELI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik “Alternativa” duke e zëvendësuar anëtares e Kuvendit Komunal **znj.Mimoza Kusari -Lila**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së , që ky vendim t’i komunikohet **znj.Drita Buza Zhaveli**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 27.11.2017,nr.2368/2017, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Mimoza Kusari- Lila, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye se është zgjedhur deputete e Kuvendit të Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirënditur, e cila është Drita Buza Zhaveli, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 07.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka
Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Prishtinë
Priština
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA